



NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE

RAPORT I ANALIZËS SË ZGJEDHJEVE

Numri 2, 4 qershor 2013

AFATE ZGJEDHORE

3 qershor: Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të) emërojnë anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV).

10 qershor: Dita e fundit për dorëzimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të kërkesave për akreditimin e vëzhguesve vendorë.

13 qershor: KZAZ-të caktojnë Grupet e Numërimit të Votave

20 qershor: Dita e fundit për dorëzimin në KQZ të kërkesave për akreditimin e vëzhguesve ndërkombëtarë

22 qershor: Fundi i fushatës zgjedhore; Fillimi i 'Heshtjes Zgjedhore'

23 qershor: Dita e Zgjedhjeve

NË SHIFRA

12 Qarqe Zgjedhore

140 Mandate

7,149 Kandidatë

3,270,936 Votues

5,506 Qendra Votimi



Shqipëria do të mbajë zgjedhje parlamentare në datë 23 qershor 2013. Instituti Demokratik Amerikan po analizon procesin zgjedhor përmes këtij numri raportesh, i [bazuar në eksperiencën 20-vjeçare në Shqipëri](#) dhe në [Raportin e Vlerësimit të Situatës Parazgjedhore të marsit 2013](#), i cili dha rekomandime për rritjen e besueshmërisë së procesit zgjedhor bazuar në standarde ndërkombëtare.

Informacioni i përfshirë në këtë raport, i cili mbulon periudhën 22 maj deri 3 qershor, bazohet në vëzhgim të drejtpërdrejtë të aktiviteteve zgjedhore si dhe në rreth 65 intervista me zyrtarë qeveritarë dhe përfaqësues të partive, anëtarë të Komisioneve të Administrimit të Zonave Zgjedhore (KZAZ), teknikienë, dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare ndërkombëtare dhe vendore në të gjithë 12 qarqet e Shqipërisë.

HYRJE

Periudha zyrtare e fushatës filloi më 24 maj. Fushata zgjedhore duket të jetë duke u fokusuar në çështje thelbësore më shumë sesa në zgjedhjet e kaluara. Çështjet ekonomike -- dhe në rradhë të parë kryesisht krijimi i vendeve të punës -- janë çështjet qendrore të kësaj fushate, çka reflekton pikëpamjet që qytetarët shprehën në studimin e fokus-grupeve që NDI organizoi në tetor 2012. Megjithatë, në nivel kombëtar, sulmet e hidhura e të vazhdueshme verbale dhe retorika nxitëse e liderëve të partive rrezikon tensionimin e kësaj fushate relativisht të qetë zgjedhore, veçanërisht në qoftë se një gjuhë e tillë përshkon bazën e këtyre partive.

Nivelet dytësore të administrimit të zgjedhjeve kanë shprehur shqetësimin se ndërhyrjet e pavend të partive politike në punën e tyre do të dëmtojnë përpjekjet e tyre për të administruar zgjedhjet në një mënyrë profesionale dhe të paanshme. Në nivel kombëtar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) vazhdon të funksionojë me vetëm katër anëtarë (siç është detajuar [në Analizën e parë të Zgjedhjeve të NDI-së](#)) por deri tani kjo gjë nuk i ka krijuar KQZ-së vonesa në vazhdimin e përgatitjeve të nevojshme për zgjedhjet.

Këto zgjedhje paraqesin një garë të ngushtë mes koalicionit qeverisës të drejtuar nga Partia Demokratike (PD) dhe kryesuar nga Kryeministri Sali Berisha, dhe nga një koalicion opozitar i drejtuar nga Partia Socialiste, kryesuar nga ish-kryebashkiaku i Tiranës Edi Rama, dhe nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), e kryesuar nga ish-Kryeministri dhe ish-aleati i Berishës, Ilir Meta. Disa parti të reja që garojnë për herë të parë mund të kenë ndikim në rezultatin e zgjedhjeve.

Shqipëria aspiron integrimin në Bashkimin Europian (BE), i cili ka deklaruar se kandidatura e vendit mund të ecë përpara nëse zgjedhjet e ardhshme plotësojnë standardet demokratike ndërkombëtare. Shqipëria ende nuk ka mbajtur zgjedhje që kënaqin plotësisht standardet ndërkombëtare të zgjedhjeve. Këto votime i ofrojnë Shqipërisë mundësinë për të treguar angazhimin e saj për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Të gjithë aktorët e përfshirë në zgjedhje – duke përfshirë partitë qeveritare dhe ato opozitare, administruesit zgjedhorë, organizatat qytetare, dhe votuesit – kanë përgjegjësi për të siguruar respektimin e parimeve të drejtësisë, ruajtjes së qetësisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë.

FUSHATA

Megjithëse periudha zyrtare e fushatës filloi në 24 maj, u vërejt që në të gjithë vendin fushata nisi muaj përpara datës zyrtare. Megjithatë, partitë intensifikuan aktivitetet e fushatës për prezantimin e kandidatëve tek zgjedhësit dy javë përpara nisjes zyrtare të fushatës duke organizuar takime publike, turne me autobuzë dhe mitingje për hapjen e fushatës. Nisja e fushatës përpara datës zyrtare është në shkelje të kodit zgjedhor dhe iu nënshtrohet sanksioneve administrative nga KQZ. Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV), një grupim vëzhguesish qytetarë vendorë, e ka nxitur KQZ-në të ndërmarrë veprime për partitë



Flamujt e PD, PS e LSI në rrugën kryesore në Elbasan

që e nisën fushatën përpara datës zyrtare të nisjes së fushatës; megjithatë deri tani nuk është vënë asnjë gjobë.

Dy javët e para të fushatës zyrtare, drejtuesit e partive politike, kandidatët dhe ekipet e fushatës kanë intensifikuar aktivitetet e tyre me zgjedhësit, duke punuar për të siguruar mbështetje duke mbajtur mitingje publike, duke shpërndarë dhe afishuar tabela dhe fletëpalosje fushate, duke dekoruar makinat me ngjyrat e partive, dhe duke mbajtur takime me qytetarët në nivel bashkie e komune. Përveç këtyre, partitë kanë nisur fushatën në media me anë të reklamave të paguara dhe disa prej tyre kanë nisur edhe aktivitete derë-më-derë në bazë.

Nga bashkëbisedimet dhe vëzhgimet e përgjithshme të NDI-së, atmosfera e fushatës në nivel vendor duket kryesisht e qetë, megjithëse pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve presin që fushata të 'nxehet' dhe tensionohet më shumë me afrimin e ditës së zgjedhjeve. Përfaqësues të degëve vendore të partive politike kryesore shprehen se janë të përkushtuar të shmangin sulmet personale dhe shprehin dëshirën për të mbajtur fushata të bazuara në problematika. Këto mendime bëjnë kontrast me veprimet e drejtuesve të partive, të cilët vazhdojnë të bëjnë akuza të forta personale në mitingje fushate, të cilat raportohen gjerësisht nga mediat kryesore. Kjo sjellje është në kundërshtim me rekomandimin e raportit parazgjedhor të NDI që partitë politike të mos përdorin gjuhë apo sjellje të tjera që denigrojnë figurën e kundërshtarit dhe ulin besimin e publikut në procesin politik. Përdorimi i retorikës negative në nivel kombëtar ka ngritur shqetësime të disa përfaqësues vendorë të partive mbi përshkrimin e mundshëm të kësaj retorike në atmosferën e fushatës në nivel vendor, që deri tani ka qenë e qetë.

EKONOMIA, PRIORITETI KRYESOR NË GJETJET E GRUPEVE TË FOKUSUARA TË PUBLIKUAR NGA NDI

NDI zhvilloi disa grupe të fokusuar në tetor të vitit 2012. [Gjetjet kryesore](#), të mbështetura gjithashtu nga hulumtime të mëvonëshme të opinionit publik të kryera nga organizata lokale, përfshijnë:

- Qytetarët shprehen se shqetësimi i tyre kryesor është gjendja ekonomike, duke përfshirë nivelin e lartë të papunësisë, standardet e ulëta të jetesës për shkak të rritjes së çmimeve, dhe pagat e pamjaftueshme;
- Shkalla e lartë e korrupsionit, inefiçenca dhe mungesa e shërbimeve në sektorin e shërbimit shëndetësor dhe në arsim citohen vazhdimisht si arsye të cilësisë së ulët të jetës së qytetarëve;
- Për shkak të perceptimit për rritjen e shkallës së kriminalitetit në vend, siguria personale është bërë një ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve;
- Korrupsioni dhe mungesa e shtetit ligjor përmenden shpesh nga pjesëmarrësit si sfidat kryesore me të cilat përballet vendi.
- Pjesëmarrësit shprehën një ndjenjë të thellë mosbesimi ndaj politikanëve të vendit – si në pushtet dhe në opozitë – të cilët sipas tyre duket sikur aspirojnë për pushtet dhe poste publike vetëm për përfitime personale.
- Megjithëse pjesëmarrësit pranojnë se politika ka një ndikim të ndjeshëm në jetën e tyre të përditshme, ata ndihen pak të lidhur me përfaqësuesit e tyre jashtë periudhave zgjedhore.

Mediat kanë raportuar disa incidente dhune kundër kandidatëve dhe përfaqësuesve vendorë të partive në disa qarqe, përfshirë një shpërthim eksplozivi në pallatin ku jeton kandidati i PD-së në Vlorë, të shtëna me armë drejt makinës së kryetarit të degës së PD-së në Shtiqën (Kukës), dhe shpërthim eksplozivi jashtë banesës dhe biznesit të kryetarit të PS-së në komunën Prezë (Tiranë). Megjithëse këto sulme të dënuara rreptë nga kryetarët e partive kryesore nuk janë konfirmuar si të motivuara politikisht, ato përfaqësojnë një rritje potencialisht shqetësuese të incidenteve të dhunës gjatë fushatës.

Në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, fushatat duken të jenë më shumë të përqendruara në çështje thelbësore, çka duhet t'ju mundësojë zgjedhësve të bëjnë dallime më të qarta mes politikave të partive të ndryshme. Partia Demokratike (PD), nën sloganin “Ne jemi ndryshimi, përpara” argumenton se vijimëria

e drejtimit të saj nevojitet për të përfunduar ndryshimet që PD ka nisur tetë vjet më pare kur erdhi në pushtet. Si suksese të saj kjo parti përmend krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimet në infrastrukturë dhe shërbime publike, si dhe meritën për sigurimin e anëtarësisë të Shqipërisë në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe ndërmarrjen e hapave të vendosur drejt integritit në Bashkimin Europian (BE). PD premton të vazhdojë reformat që mbështesin hapjen e vendeve të punës, promovojnë bizneset e reja dhe nxisin zhvillimin e industrisë, bujqësisë, energjetikës, turizmit dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit.

Partia Socialiste (PS) ka zgjedhur sloganin “Rilindje”, duke e pozicionuar veten si një alternativë përballë qeverisë, e cila sipas saj e ka zhytur vendin në krizë ekonomike dhe korrupsion. Partia ka ofruar një program për rimëkëmbjen ekonomike bazuar në hapjen e vendeve të reja të punës dhe ofrimin e arsimit profesional për qytetarët që kërkojnë punë, uljen e kostove të jetesës për 95% të popullsisë duke hequr taksën e sheshtë, dhe rritjen e financimit publik për zhvillimin rural.

Dallimi madhor mes dy partive kryesore është politika e taksave. PD e konsideron taksën e sheshtë aktuale prej 10% si nxitje për mjedisin ekonomik dhe thekson përjashtimet nga taksat apo uljet e taksave për bujqësinë dhe biznesin e vogël. Socialistët promovojnë sistemin e taksës progresive i cili do të ulte taksat për punonjësit me të ardhura të ulëta dhe mesatare, në kurriz të personave me të ardhura më të larta, si dhe heqjen e taksave për ushqimet bazë dhe ilaçet.

Partia e tretë më e madhe në vend, LSI, ka sloganin “Të ecim më shpejt”, duke aluduar mbi nevojën e Shqipërisë për të ecur më shpejt në rrugën e integritit në BE. Ajo krenohet me suksesin e arritur në bashkimin e partive qeverisëse dhe opozitare në miratimin në parlament të të ashtuquajturave “ligje të reformës për në BE” – mbi Gjykatën e Lartë, rregulloren e parlamentit dhe statusin e nëpunësit civil – që së bashku me përmbushjen e kriterit të mbajtjes

PROFILI I NJË VOTE TË VJEDHUR

Shembujt më të shpeshtë të pretendimeve për praktika të jashtëligjshme, të përshkruara për analistët e NDI-së, janë:

- Detyrimi i punonjësve të sektorit publik për të nënshkruar një zotim për të votuar për një parti të caktuar, nën kërcënimin e humbjes së punës, uljes në detyrë apo ndëshkimeve të tjera materiale;
- Pagesa financiare ose materiale për të votuar një parti të caktuar në këmbim të një zotimi të nënshkruar, prodhimit të një prove fotografike, ose tregimit të shpejtë të fletës së shënuar të votimit komisionerëve të partisë në qendrën përkatëse të votimit;
- Veçanërisht në zonat rurale me popullsi të theksuar fetare, pagesat për të votuar një parti të caktuar shoqërohen me zotime mbi një libër fetar;
- Pagesa për të mos votuar një parti të caktuar, në mënyrë që të ulet numri i votuesve për partinë kundërshtare, në këmbim të kartës së identitetit, e cila kërkohet për të votuar ditën e zgjedhjeve; dhe
- “Votimi karusel”, ku një votues pajiset me një fletë votimi të shenjuar dhe të plotësuar paraprakisht, përpara se të hyjë në qendrën e votimit. Fleta boshe e votimit, me të cilin votuesi pajiset brenda qendrës së votimit, rikthehet si provë që fleta e votimit e shenjuar paraprakisht është hedhur në kutinë e votimit. Më pas procesi përsëritet.

së zgjedhjeve demokratike, do t’i mundësojë Shqipërisë marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE në vitin 2013. Ashtu si PD dhe PS, LSI-ja thekson planet e saj për krijimin e vendeve të punës dhe nevojën për reformë ekonomike. Në këto zgjedhje kemi dy parti të reja politike kryesore që po organizojnë një fushatë aktive dhe po garojnë si të pavarura nga dy koalicionet kryesore – Fryma e Re Demokratike (FRD) dhe Aleanca Kuq e Zi (AKZ). Të dyja këto parti po përdorin mesazhe kundër establishmentit, drejtuar si forcave të majta ashtu dhe atyre të djatha, dhe po përqëndrohen kryesisht në fuqizimin e institucioneve shtetërore dhe luftën kundër korrupsionit.

SHTRËNGIMI I VOTUESVE & BLERJA VOTES

Edhe pse misioni i NDI-së për vlerësimin e situatës para-zgjedhore rekomandoi që liderët e partive politike dhe qeveritarët të shmangin praktikën që shtrëngojnë votuesit për mbështetje në zgjedhje, analistët zgjedhorë të NDI-së kanë dëgjuar pretendime të përsëritura për praktika të jashtëligjshme të përhapura gjatë periudhës së fushatës zgjedhore – mbi të cilat KVV dhe media gjithashtu vazhdojnë të raportojnë. Disa përfaqësues të partive politike kanë pranuar te NDI se partitë e tyre do të blejnë vota. Kodi Penal është ndryshuar duke futur ndëshkime më të rënda për çdo person që përfshihet në shtrëngim të votuesve dhe blerje votash. Këto aktivitete tani janë të dënueshme me gjoba ose me burgim deri në gjashtë muaj.

ABUZIMI I BURIMEVE SHETËRORE

Pavarësisht thirrjes publike të Kryeministrit Sali Berisha që burimet shtetërore të mos përdoren për qëllime fushate, [fjalimet](#) dhe [fotot](#) e fushatës së PD-së janë postuar në faqet zyrtare të qeverisë. Gjithashtu, si PD ashtu dhe PS janë akuzuar nga njëra tjetra, por edhe nga partitë e vogla, se po abuzojnë me burimet e administratës vendore në bashkitë ku ato janë në pushtet.

Edhe pse deri në 3 qershor nuk ka pasur ankime zyrtare, pranë analistëve të NDI-së, si dhe nga grupet e vëzhguesve vendorë dhe mediat, janë raportuar akuza specifike mbi përdorimin e jashtëligjshëm të burimeve shtetërore për fushatë. Ka pretendime se mësuesit dhe punonjës të tjerë të sektorit publik janë kërcënuar me humbje të punës nëse shprehen hapur kundër koalicionit qeverisës dhe duket se disave u është kërkuar të nënshkruajnë për të vërtetuar pjesëmarrjen e tyre në mitingje politike. Në Shkodër dhe Peshkopi, NDI u njoftua nga burime të ndryshme se studentët dhe mësuesit janë transportuar me autobusë për në mitingjet e fushatës së PD-së. Kodi zgjedhor qartësisht ndalon abuzime të tilla të burimeve shtetërore.

Si rezultat i rasteve të shumta të raportuara nga mediat mbi abuzimin e burimeve publike, Avokati i Popullit doli me një deklaratë publike ku u bëhej thirrje qytetarëve dhe punonjësve të administratës publike të ankohen zyrtarisht pranë zyrës së tij në rast se bëhen subjekte të presionit për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës. NDI rithekson rekomandimin nga raporti para-zgjedhor se autoritetet përkatëse duhet të hetojnë dhe të ndjekin penalisht rastet e ankimeve zyrtare të shfrytëzimit të burimeve publike për qëllime fushate.

ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE – KQZ DHE KZAZ-TË

Fundjavën që nisi në datën 17 maj, KQZ zhvilloi trajnime dy-ditore nëpër të gjithë vendin për komisionerët e Zonave të Administrimit Zgjedhor. Sipas informacionit që NDI ka marrë nga KQZ, deri tani nga partitë politike përkatëse janë ndërruar rreth 10 përqind e numrit të përgjithshëm të komisionerëve të KZAZ-ve. Megjithatë kodi nuk i ndalon partitë politike të ndryshojnë anëtarët e tyre në KZAZ pas formimit të tyre në 25 mars, zëvendësimi i shpeshtë për arsye politike krijon një barrë të panevojshme administrative dhe financiare për KQZ-në dhe nuk u mundëson anëtarëve të rinj njohjen me rregullat dhe procedurat e administrimit të zgjedhjeve. Kryetarja e KQZ-zë në mënyrë të vazhdueshme dhe publike, u ka kërkuar partive politike të frenojnë zëvendësimin arbitrar të përfaqësuesve të KZAZ-ve. Zëvendësimet duhet të lejohen vetëm për arsye specifike të shprehura qartë në kod.

Kryetarët e KZAZ-ve u kanë raportuar analistëve të NDI-së se ka filluar puna për përgatitjen e periudhës së votimit dhe asaj të numërimit të votave. Ndër të tjera, anëtarët e KZAZ-ve në qarqet e Kukësit dhe Elbasanit shprehën shqetësim për ndërhyrje të partive politike përmes ushtrimit të presionit tek administratorët e zgjedhjeve, në veçanti atyre të qendrave të votimit dhe të qendrave të numërimit të votave, siç edhe ka ndodhur në zgjedhjet e mbajtura në të shkuarën në Shqipëri. Një numër anëtarësh të KZAZ-ve nga të dyja partitë kryesore e cilësuan KQZ-në – e cila vazhdon të funksionojë me vetëm katër anëtarë, tre prej të cilëve të emëruar nga mazhoranca qeverisëse – si partiake dhe u shprehën të shqetësuar se kjo anshmëri në nivel qendror mund të minojë përpjekjet e tyre për të administruar një proces zgjedhor të besuar. Raporti parazgjedhor i NDI-së rekomandoi se partitë politike duhet të mbështesin pavarësinë e organeve të administrimit të zgjedhjeve dhe të mos ndërhyjnë në proces, pasi administrimi profesional dhe i paanshëm i zgjedhjeve është thelbësor për krijimin e besimit në rezultatet e zgjedhjeve.

Që nga raporti i fundit i NDI-së për zgjedhjet, i datës 22 maj, KQZ-ja ka marrë disa vendime, mes të cilave ka: miratuar listën e kandidatëve dhe të renditjes së partive në fletën e votimit, ngritur bordin e monitorimit të zgjedhjeve, përfunduar listën e qendrave të votimit, si dhe përcaktuar vendndodhjet për

qendrat e numërimit të votave. Megjithëse Kodi Zgjedhor përcakton se disa vendime të KQZ-së, si ato për caktimin e rregullave të hedhjes së shortit për të përcaktuar renditjen në fletën e votimit (neni 98, pika 5), janë akte normative që kërkojnë pesë vota për t'u miratuar, KQZ-ja me katër anëtarë po vazhdon të marrë vendimet e nevojshme për të përmbyllur përgatitjet për zgjedhjet. Megjithë kundërshtimet e përfaqësuesit ligjor të PS-së për mundësinë e KQZ për të marrë disa vendime me vetëm katër anëtarë, nuk është depozituar asnjë ankimim zyrtar. Pa një KQZ me anëtarësi të plotë në ditën e zgjedhjeve, procesi i zgjedhjeve lihet i hapur për ankimim juridik.

Siç është përmendur në *Raportin e mëparshëm të Analizës së Zgjedhjeve*, numri më i lartë nga ç'pritej i partive dhe i kandidatëve për fletën e votimit në Fier, krijoi probleme teknike për pilotimin e sistemit të numërimit elektronik në këtë qark me shumë konkurrencë e me numër të lartë zgjedhësish. KQZ-ja nuk ka vendosur ende nëse do të vazhdohet me këtë projekt apo jo, por vendimi duhet marrë shpejt në mënyrë që të shmangen paqartësitë në lidhje me mënyrën e nxjerrjes së rezultateve për këtë qark.

[Instituti Demokratik Amerikan për Çështje Ndërkombëtare \(NDI\)](#) është një organizatë jo-fitimprurëse që punon për përhapjen dhe forcimin e demokracisë kudo në botë, duke siguruar mbështetje praktike liderëve politike dhe shoqërisë civile për zhvillimin e vlerave, praktikave dhe institucioneve demokratike të vendeve të tyre. NDI punon në Shqipëri që nga viti 1991, duke nxitur rritjen e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje në nivel lokal dhe kombëtar, duke organizuar dhe mbështetur monitorimin e zgjedhjeve, edukimin e votuesve dhe duke nxitur zhvillimin e partive politike dhe liderëve të rinj. NDI është një organizatë jo-partiake që punon me të gjitha partitë politike në Shqipëri, me organizata jo-qeveritare vendase, grupe qytetare, institucione qeverisëse dhe organizata ndërkombëtare.

Për më shumë informacion, jeni të lutur të kontaktoni: Ana Kadovic, NDI/Drejtoreshë për Shqipërinë
akovacevic@ndi.org | Tel/fax: +355 42 271 281 | Cel: +355 69 20 30 212



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Ky raport mundësohet me mbështetjen e Popullit Amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e NDI dhe nuk reflekton domosdoshmërisht